

# Komunikimi kuptimplotë

## Konteksti dhe objektivat:

Personaliteti i referohet modeleve të të menduarit, të ndjerit dhe të sjelljes së individit. Personaliteti nuk ndikon vetëm në mënyrën si ne lëvizim dhe përgjigjemi në ambientin tonë, por gjithashtu shkakton mënyrat tona të reagimit. Për t'a kuptuar diversitetin e natyrës njerëzore dhe ndikimin e saj në komunikimet dhe marrëdhëniet, u zhvillua modeli Riemann-Thomann. Në thelb, ky model i ndihmon individët të kuptojnë modelet e sjelljes së tyre. Komunikimi nuk është gjë tjetër veç përcjellja dhe shkëmbimi i informacioneve. Ky proces shkëmbimi është i lidhur ngushtësisht me brendinë/ kontekstin, marrëdhënien, pritshmëritë dhe faktorë të tjerë. Aksioma e Paul Watzlawick "Ju nuk mund të mos komunikoni" do të thotë se ne komunikojmë edhe kur nuk themi gjë, porse përcjellim shprehje nëpërmjet fytyrës apo gjesteve. Njeriu ka një ndjeshmëri mjaft të lartë kundrejt sinjaleve jo verbale.

## Elementë kyç që do trajtohen gjatë trajnimit:

- Komunikimi është aktiviteti i përcjelljes së shkëmbimit të informacioneve. Ky proces shkëmbimi është shumë i lidhur me kontekstin, marrëdhënien, pritshmërinë dhe faktorë të tjerë.
- Të kuptuarit të personalitetit të dikujt dhe se si ndërlidhet me sjelljen
- Të kuptuarit të vlerave të dikujt dhe ndikimin në punë
- Të kuptuarit të koncepteve bazë të komunikimit kuptimplotë
- Të kuptuarit të diversitetit njerëzor dhe ndikimeve të tij në komunikim dhe marrëdhënie
- Mjete për të dhënë/ përcjellë mesazhe të qarta dhe të kuptueshme
- Arti i të pyeturit në kuadër të përmirësimit të komunikimit; stimulimi/ ngacmimi i të menduarit dhe vënia e trurit në punë

## Metodologjia

Sesionet e trajnimit janë dizenuar të jenë interaktive. Eksperienca na ka treguar se pjesëmarrësit nxënë më shumë në aktivitetet në të cilat përfshihen aktivisht. Në një kohë të shkurtër ne njëkohësisht maksimizojmë impaktin e mësimit si edhe përfshijmë personalisht në aktivitete çdo pjesëmarrës të grupit.

## Target Grupi

Specialistë sektori, mbikëqyrës/ supervizorë, drejtues skuadrash dhe/ ose menaxherë

**Kohëzgjatja:** 2 ditë (09:00 - 17:00)

**Tarifë pjesëmarrjeje:** Për t'u përditësuar

**Përfshirë në çmim:** 2 pushime kafe + dreka